



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:161656
Datë: 27.03.2024
Numri i dokumentit: 05508383

C.nr.589/21

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil, gjyqtari Petrit Curri në çështjen juridike kontestimore të paditëses Y.B. nga fshati T./Malishevë, të cilën me autorizim e përfaqëson Av. Liri Krasniqi nga Malisheva kundër të paditurës Komuna e Malishevës/Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti “kompensimi një (1) page jubilarë”, vlera e kontestit 210.50 euro, jashtë seancës gjyqësore me datë 27.03.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar** kërkesëpadia e paditëses Y. B. nga fshati T./Malishevë dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit që paditëses Y.B.në emër kompensimit të shpërblimit jubilar për 10 vite të përvojës së punës, në vlerë të 50% të një page bazë (vlera e pagës bazë 421.00 euro), t’ia kompensoj shumën prej **210.50 € (dyqind e dhjetë euro e pesëdhjetë cent)**, me kamatë ligjore prej 8% që nga dita e paraqitjes së padisë me datë 19.07.2021 dhe në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.
- II. REFUZOHET** si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit mbi shumën e aprovuar sikurse në pikën -I- të këtij dispozitivi dhe atë shumën prej 84.79 euro.
- III. OBLIGOHET** e paditura që paditëses t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 98.00 euro (nëntëdhjetë e tetë euro) dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumën prej 78.00 euro dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 20.00 euro në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm, ndërsa **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa e paditëses për kompensimin e shpenzimeve mbi shumën e aprovuar.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve:

Paditësja Y. B. nga Malisheva, përmes të autorizuarës së saj Av. Liri Krasniqi nga Malisheva, pranë kësaj gjykate me datën 19.07.2021 ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e një page jubilarë.

Në padi, e autorizuar e paditëses ka theksuar se paditësja ka themeluar marrëdhënie pune te e paditura në SH.F.M.U. "H. P." në T. prej vitit 01.09.2010 dhe vazhdon të punoj ende në atë shkollë, ku ka përvojë pune në kohëzgjatje prej 10 vite, 8 muaj dhe 27 ditë.

Ka shtuar se paditësja ka bërë kërkesë për kompensimin e një page jubilarë, por e paditura që është punëdhënës i paditëses, nuk e ka aprovuar kërkesën dhe përkundër faktit se një kërkesë e tillë ka qenë e bazuar. Gjatë kësaj periudhe kohore, e paditura fare nuk i ka përfillur dhe realizuar dispozitat nga Kontrata Kolektive për rastet e pagave jubilarë të punëtorëve të arsimit.

Andaj, duke marrë për bazë këto rrethana, ka kërkuar nga gjykata që pas administrimit të provave të nxjerrë aktgjykim me të cilin do të aprovohej kërkesëpadija e paditëses Y.B. dhe të obligohet e paditura që paditëse t'ia paguaj një page jubilarë ashtu siç parashihet me Kontratën Kolektive duke e llogaritur kamatën ligjore dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

E autorizuar e paditëses me parashtrësë ka bërë precizimin e kërkesë-padisë duke theksuar se në bazë të listës së pagave, paditësja e ka pagën bruto 590.59 euro dhe për 10 vite përvojë pune në 50% të një page bazë, shuma e pagesës për një pagë jubilarë duhet të jetë 295.29 euro. Andaj ka kërkuar nga gjykata që të nxjerrë aktgjykim me të cilin do ta detyronte të paditurën që t'ia paguaj shumen prej 295.29 euro me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive.

Ka kërkuar shpenzimet e procedurës në vlerë prej 260.00 euro dhe atë për përpilimin e padisë, taksat gjyqësore dhe precizimin e kërkesëpadisë.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditëses, e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi.

E paditura Komuna e Malishevës, përmes të autorizuarit së saj Mujë Sahitaj-avokat publik i komunës, në këtë gjykatë ka parashtruar përgjigje në padi me datë 29.02.2024, ku ka theksuar se kemi të bëjmë me parashkrim të borxhit pasi nuk ka qenë Kontrata Kolektive në fuqi dhe nuk ka asnjë bazë ligjore, pasi që Kontrata Kolektive është shkëputur me datë 21.11.2022, ndërsa borxhi është kërkuar pas kësaj date.

Ka shtuar se e konteston vlerën e borxhit lidhur me këtë çështje, pasi që Kontrata Kolektive e Arsimit e lidhur mes SBASHK-ut dhe MASHT-it është shkëputur dhe tani nuk është në fuqi dhe se palët që e kanë nënshkruar nuk kanë pasur legjitimitet. Meqenëse kjo kontratë nuk është më në fuqi pasi është shkëputur nga MASHT, komuna dhe DKA nuk kanë legjitimitet pasiv në këtë procedurë, por këtë legjitimitet e ka MASHT.

Për fund i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj padinë e paditësit si të pabazuar.

Vlerësimi i gjykatës:

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata i shqyrtoi këto prova dhe atë: Kontratën e punës nr.... të datës 25.02.2021, vërtetimin mbi përvojën e punës të lëshuar nga SHFMU "H. P." në T. me nr. të protokollit ... të datës 02.04.2021, lista e pagave e lëshuar nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe letërnjoftimi e paditëses.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se nga kontrata e punës nr.... për paditësen e lëshuar nga Komuna e Malishevës-Drejtoria për Arsim (këtu e paditura), paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën SHFMU “H. P.” në T./Malishevë, si edukatore me kualifikim Bachelor i Arteve në Përkujdesje dhe Mirëqenie të Fëmijëve.

Nga vërtetimi mbi përvojën e punës me nr.... i lëshuar nga SHFMU “H. P.”, vërtetohet fakti se paditësja punon si edukatore në SHFMU “H. P.” nga data 01.09.2010 ku të njëjtën punë e kryen edhe tani dhe ka përvojë pune gjithsej 10 vite e 7 muaj.

Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet fakti se paditësja realizon pagë bruto 590.29 euro, neto 527.15 euro kurse pagën bazë e ka në lartësi prej 421.00 euro, kjo listë e pagave vërtetohet edhe me numrin personal nga letërnjoftimi i paditëses.

Baza ligjore:

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Vërtetimet e lartcekura, Gjykata i pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1 të LPK-së në të cilin paragraf përcaktohet se: *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”* Andaj, meqë këto janë dokumente të lëshuara nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e të cilat edhe si të tilla janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, dhe janë prova me të cilat vërtetohen faktet lidhur me marrëdhënien dhe përvojën e punës, kështu që gjykata ua fali besimin e plotë.

Bazuar në Ligjin e Punës Nr.03/L-212 Gazeta Zyrtare Nr. 90/01 Dhjetor 2010, në dispozitat e nenit 90 par. 5 lidhur me Marrëveshjen Kolektive përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*, lidhur me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, ku me nenin 3 paragrafin 2 përcaktohet se: *“I (e) punësuar do të thotë punëtor ose punëtore, i/e cili/cila ka lidhur marrëdhënie pune në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, Kontratës Kolektive në nivel të vendit dhe kësaj kontrate”*, meqenëse në rastin konkret është vërtetuar se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura

dhe lidhur me kërkesën për kompensimin në emër të pagës jubilarë, u vendos që të njëjtën ta aprovoj pjesërisht dhe atë 50% të pagës bazë (421.00 euro) për 10 vite përvojë pune, e jo ashtu siç e ka kërkuar paditësja 50% të pagës bruto (paga bruto 590.29 euro) për 10 vite përvojë pune,

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe 22.01.2021.

Me nenin 35 par. 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021 është paraparë se: “*Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar në vlerë: nën par.8.1: “Për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë të 50% të një page bazë”*”, pra në rastin konkret paga bazë e paditëses është 421.00 euro dhe kur e kalkulojmë me 50% të kësaj page, atëherë shuma del të jetë 210.50 euro.

Si pretendim i dhënë në përgjigje në padi nga e paditura se në rastin në fjalë kemi parashkrim të borxhit, gjykata një pretendim të tillë e ka refuzuar si të pabazuar, për arsye se konform nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i njëjti ka përcaktuar se: “*Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*”, e që në rastin konkret paditësja ka kërkuar që t’i kompensohet paga jubilarë për 10 vite punë të cilat sipas vërtetimit i ka arritur në vitin 2020, ndërsa padinë e ka paraqitur me datë 19.07.2021, pra brenda afatit prej tre viteve nga kur edhe ka lindur e drejta për kërkesën nga marrëdhënia e punës.

Ndërsa sa i përket pretendimeve se e konteston vlerën e borxhit lidhur me këtë çështje, pasi që Kontrata Kolektive e Arsimit e lidhur mes SBASHK-ut dhe MASHT-it është shkëputur dhe tani nuk është më në fuqi dhe se palët që e kanë nënshkruar nuk kanë pasur legjitimitet, edhe ky pretendim është i pabazuar sepse siç u cek edhe më lart, padia është dorëzuar në gjykatë me datë 19.07.2021 pra në kohën kur Kontrata Kolektive e Arsimit ka qenë në fuqi e siç dihet Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 ka qenë në fuqi deri me datën 21.01.2021, kurse Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 ka qenë në fuqi deri me datën 21.11.2022 kur edhe është anuluar nga MASHT, kjo bazuar edhe në Mendimin Juridik për Shpërblimin Jubilar të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës nr.40/2023 të datës 27.02.2023.

Pjesa refuzuese:

Gjykata e ka refuzuar si në pikën -II- kërkesën e paditëses përtej shumës së aprovuar, pasi që shuma e kërkuar nga paditësja ka qenë 295.29 euro ose 50% e pagës bruto, kurse me nenin 35 paragrafi 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021 është paraparë se: “*Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar në vlerë: nën par.8.1: “Për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë të 50% të një page bazë”*”, pra 50% të pagës bazë, e në këtë rast paga bazë është 421.00 euro e kur e kalkulojmë me 50%, shuma del të jetë 210.50 euro.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse të kompensimit dhe duke e llogaritur me kamatë ligjore prej 8 %, bazuar në nenin 382 par.1 dhe 2 të LMD-së nga dita e parashtrimit të padisë (19.07.2021), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me dëm material.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori konform nenit 453 par. 1 dhe 2 të LPK-së, në të cilën përcaktohet se (Neni 453.1): *“Me rastin e vendosjes se cilat shpenzime do t’i shpërblehen palës, gjykata do të marrë parasysht vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe mbi shumën e shpenzimeve, vendos gjykata duke çmuar me kujdes të gjitha rrethanat”*, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 të Rregullores për Tarifën e Avokatëve të Kosovës, e cila rregullore përcakton se përpilimi i padisë në kontestet e vlerës së vogël (nën 500.00 euro, siç është në rastin konkret) është në shumën prej 78.00 euro, ashtu që vendosi që paditësit t’ia njoh shpenzimet e procedurës duke e detyruar të paditurën që t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 98.00 euro dhe atë në emër të parashtrimit të padisë shumën 78.00 dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 20.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 143 dhe 398 të LPK-së.

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.589/21, datë 27.03.2024

Gj y q t a r i
Petrit Curri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.